**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 116 dhe 118 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Aprovohet ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 115, 117, 119 dhe 120 elektronike/ korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 02/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 24 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID 19, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në zbatim të paragrafit 4. të nenit 2. të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e 580 (pesëqindetetëdhjetë), specializantëve me vetëfinancim, nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere", nën-programi, Aftësimi Specialistik dhe EVM me kod 90300, në vlerë prej 4,129,020.00 € (katër milionë e njëqindenjëzetenëntë mijë e njëzetë euro) prej datës 1 janar 2023 deri me datë 31 dhjetor 2023.

2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera relevante, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Nr. 03/127
Datë: 08.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për pagesën e 10 (dhjetë) specializantëve me vetëfinancim nga Republika e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonia e Veriut nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere" nën-programi Aftësimi Specialistik dhe EVM me kod 90300, në vlerë prej 71, 190.00 € (shtatëdhjetenjë mijë e njëqindenëntëdhjetë euro) prej datës 1 janar 2023 deri me datë 31 dhjetor 2023.

2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera relevante, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 04/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Transferim të Personave të Dënuar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Drejtësisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 05/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Civile ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Drejtësisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 06/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë me Letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 07/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale të Mjekëve, Stomatologëve dhe Arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/127
Datë: 08.02.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 09/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenet 53 par.1 dhe 57 par.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

# V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi Nr.05/56 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 26.01.2022, për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe ligjore, si vijon:

- Pika 1.2 dhe pika 1.3 e Vendimit Nr.05/56 të datës 26.01.2022, fshihet.

2. Pjesa tjetër e Vendimit Nr.05/56 të datës 26.01.2022, mbetet në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 10/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 01/60 të datës 05.02.2022, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-V-425 të datës 08.11.2022 për miratimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 03/103 të datës 28.10.2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 720,000 € (shtatëqindenjëzet mijë euro), për zbatimin e masës 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213 në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11313, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Mjetet sipas këtij Vendimi përdoren për qëllim të subvencionimit të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, me qëllim të uljes së ndikimit të tarifave të energjisë, e cila pastaj reflektohet edhe në faturat e konsumatorëve.

4. Kushtet dhe kriteret e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1. e këtij Vendimi përcaktohen me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 21/94 të datës 24 gusht 2022.

5. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.

6. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë, për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 11/127**
**Datë: 08.02.2023**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, të nenit 8 paragrafit 2. dhe 4. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 shkurt 2023, merr këtë:

## V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vlera e shpenzimeve të transportit detar dhe kontejnerëve në Shtojcën 2. të Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, konform listës së çmimeve të përditësuara, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.

3. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 17/109 i datës 23 nëntor 2022.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

Dogana e Kosovës gjatë vlerësimit, analizës dhe hulumtimeve të bëra ka evidentuar se kostot e shpenzimeve të transportit detar në nivel global të shpenzimeve kanë pësuar rënie të theksuar, kryesisht si rezultat i rënies së vëllimit tregtar. Në këtë drejtim, me qëllim të ndjekjes dhe harmonizimit të çmimeve të transportit detar, Dogana e Kosovës ka rekomanduar rishikimin e shpenzimeve të transportit detar.

Mbi bazën e këtyre vlerësimeve dhe hulumtimeve të kryera nga njësitë e Doganës së Kosovës, dhe mbështetur në nenin 8, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara u vendos për rishikim të vlerave të shpenzimeve të transportit detar dhe u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Japan | | | | | | | | |
| SHBA USA SAD | New York | | 2800 | 2800 | 5600 | 5600 | 5600 | 5600 |
| Koreja e Jugut South Corea Južna Koreja | Gwangyang | | 2600 | 2600 | 4200 | 4200 | 4500 | 4500 |
| Liban Lebanon Liban | Bejrut | | 600 | 600 | 900 | 900 | 900 | 900 |
| Iran Iran Iran | | | 2200 | 2200 | 3250 | 3250 | 3250 | 3250 |
| Tunizi Tunisia Tunis | Rades | | 1650 | 1650 | 2765 | 2765 | 2765 | 2765 |
| Algjeri Algeria Alžir | Algiers | | 2000 | 2000 | 2953 | 2953 | 2953 | 2953 |
| Tajvan Taivan Tajvan | | | 3200 | 2240 | 6500 | 4550 | 6500 | 4550 |
| Vietnam Vietnam Vijetnam | Saigon | | 4120 | 2885 | 7330 | 5131 | 7330 | 5131 |
| India Cambodia Kambodži | | | 2400 | 2050 | 3700 | 3700 | 3700 | 3700 |
| Singapor Singapore Singapur | | | 3600 | 2520 | 5262 | 3690 | 5262 | 3700 |
| Bangladesh Bangladesh Bangladeš | Chittagong | | 3200 | 2240 | 4500 | 3200 | 4500 | 3250 |
| Shiri Lanka Sri Lank Siri Lanka | Colombo | | 3660 | 3400 | 6075 | 4260 | 6100 | 4300 |
| Tailanda Tailand Tajland | Bangkok | | 5050 | 4000 | 6562 | 5200 | 6562 | 5200 |

SHTOJCA 2- Tabela e Shpenzimeve të Transportit Detar me Kontejner

ANNEX 2- Table of expenses of maritime transport with container

ANNEX 2- Tabela pomorskih prevoznih troskovakontejnerom

| Relacioni- Itinerary - Relacija | | Çmimi sipas llojit të kontejnerit * Price due to container's type * Cena po vrsti kontejnera * | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shteti State Zemlja | Porti i nisjes Departure Port Luka polaska | 20FT USD | Propozimet | 40FT USD | Propozimet | 45FT USD | Propozimet |
| Hollandë Netherland Holandija | | 900 | 900 | 1250 | 1250 | 1250 | 1250 |
| Francë France Francuska | | 1100 | 1100 | 1540 | 1540 | 1540 | 1540 |
| Turqi Turkey Turska | Mersin | 615 | 615 | 700 | 700 | 700 | 700 |
| Egjipt Egypt Egipat | aleksandri suez | 554 1190 | 1050 | 720 1700 | 1700 | 720 1700 | 1700 |
| Malta Malta Malta | | 850 | 800 | 1250 | 1200 | 1350 | 1250 |
| Angli England Engleska | | 1200 | 1200 | 2000 | 2000 | 2000 | 2000 |
| Spanjë Spain Španija | | 1800 | 1800 | 2200 | 2200 | 2200 | 2200 |
| Hong-Kong Hong-Kong Hong-Kong | | 3150 | 2300 | 4500 | 3500 | 4500 | 3500 |
| Kina China Kina | | 3175 | 2050 | 5100 | 3300 | 5100 | 3300 |
| Japonia Japan | Fukuyuma | 3175 | 2100 | 5100 | 3300 | 5100 | 3350 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Indonezi<br>Indonessia<br>Indonezija | Jakarta | | 4200 | 2940 | 7250 | 5100 | 7250 | 5100 |
| Filipine<br>Philiphines<br>Filipini | Manila | | 3180 | 2225 | 5300 | 3750 | 5320 | 3750 |
| Australi<br>Australia<br>Australija | Sydney | | 3000 | 3000 | 3700 | 3700 | 3700 | 3700 |
| Kanada<br>Canada<br>Kanada | Halifax | | 3300 | 3300 | 5600 | 5600 | 5600 | 5600 |
| Portugalia<br>Portugal<br>Portugal | Lisbon | | 1770 | 1700 | 2950 | 2950 | 2950 | 2950 |
| Brazil<br>Brazil<br>Brazil | Santos | | 2450 | 2450 | 4087 | 4000 | 4200 | 4100 |
| Argjentinë<br>Argentina<br>Argentina | Bueno Aires | | 4380 | 4380 | 7300 | 7000 | 7300 | 7100 |
| Malajzi<br>Malaysia<br>Malezija | Port Kelang | | 3840 | 3840 | 6400 | 6000 | 6400 | 6100 |

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836
www.dogana-ks.org